REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJE

KRYESIA

Nr 6931 Lushnjë më 13 / 08 /2025

VENDIM

NR 07 DATE 13 / 08 /2025

PËR MIRATIMIN E RENDIT PARAPRAK TË DITËS PER MBLEDHJEN E DATËS 29.08.2025

-Kryesia e këshillit bashkiak Lushnje në mbledhjen e saj të datës 13/08/2025, pas shqyrtimit të materialeve si dhe në zbatim të vendimit te këshillit bashkiak nr.37 date 24.04.2020"Për miratimin e rregullores së funksionimit të këshillit bashkiak "Kreu II ,neni 22"Kryesia e Këshillit' pika 1,3,4,

VENDOSI :

1-Miratimin e rendit paraprak të ditës për mbledhjen e radhës të këshillit bashkiak Lushnje që do të zhvillohet më datë **29.08.2025,ditë e Premte ora** 10 **:00**.Bashkëngjitur këtij vendimi pikat e rendit paraprak te ditës.

2-Ngarkohet Sekretari i Këshillit për publikimin e njoftimit të rendit paraprak të ditës ,si dhe njoftimin e këshilltarëve ,kryetarit te bashkisë dhe cdo personi tjetër që ka bërë kërkesë për pjesëmarrje në mbledhje të këshillit.

3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYESIA E KËSHILLIT

1- Erjet Dhima

2-_____

3- Marjeta Bedeli

4- Ujkosi Koglekli

5-_____

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

Lushnjë më 13/08/2025

Nr 6932

Lënda:Thirrje mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës te këshillit bashkiak Lushnje.

ANËTARËVE TË KESHILLIT BASHKIAK LUSHNJE

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË
LUSHNJE
PREFEKTIT TE QARKUT FIER

-Në mbështetje te nenit 53 pika 4 ,neni 56 pika 2 ,shkronja"a" te ligjit 139/2015"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar ,njoftoj thirrjen e mbledhjes te radhës te këshillit bashkiak Lushnje ne sallën e këshillit bashkiak **diten e Premte, date 29.08.2025, ora 10:00**,me këtë rend dite:

1-Miratimi i rendit te ditës.
2-Projekt –Vendim: Për miratimin e fondit për familjet në nevojë që do te trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe ato që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor per muajin **Korrik** 2025 .
KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE,KOMISIONI I EKONOMISE PROBLEMEVE SOCIALE DHE STREHIMIT.
3-Projekt–Vendim: Për miratimin e familjeve që perfitojnë nga programi social i strehimit ,subvencionimi i interesave të kredisë.
KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE,KOMISIONI I EKONOMISE PROBLEMEVE SOCIALE DHE STREHIMIT.
4-Projekt–Vendim: Për miratimin e planit te arsimit parauniversitar ,bashkia Lushnje.
KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE,KOMISIONI I ARSIM KULTURË,SPORT.
5-Projekt–Vendim:Për miratimin e planit social vendor 2025-2028 ,bashkia Lushnje.
KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE,KOMISIONI I EKONOMISE PROBLEMEVE SOCIALE DHE STREHIMIT

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

6-Projekt–Vendim:Për miratimin e planit te integritetit ,bashkia Lushnje.
KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE

7-Projekt–Vendim:Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njesive të vetëqeverisjes vendore dhe këshillit të ministrave të Republikes së Shqiperisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore ,akademia e trajnimit te njesive te vetëqeverisjes vendore të Republikes së Shqipërisë **(TALGA).**
KOMISIONI PERGJEGJËS:KOMISIONI JURIDIK, RENDIT DHE SITUATAVE EMERGJENTE

8-Miratimi i proçesverbalit.

Shënim: Sjell ne vëmendje te Kryetarëve te Komisioneve V.K.B-në nr. 37 date 24.04.2020"Mbi miratimin e rregullores së funksionimit te këshillit bashkiak Lushnje"dhe konkretisht nenet 34,35,36,37,38.

-Duke ju falenderuar!

KRYETARI
Erjet Dhima

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com